ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 219/17
Datë/Datum 13.07.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Një ankesë kundër: *KK Kaqanik*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i prok: 652-17-2200-121

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me instrument mates gjeodezik**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Ageo&Co Shpk

Prishtinë
[redacted]

Kujtim Vuqiterna

13.07.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

Per: Vuqiterna
(Nënshkrimi dhe vula)

AGEO & CO
PRISHTINE-PRISHTINA

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për dhënie te kontratës është bërë, me datën 15.05.2017

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Procesi i hapjes ka qenë në rregull

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po [ ] **Jo** [ ]

Nuk jemi njoftu me letër standarde

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë vlerësimit të këtij tenderi ka bërë shkelje të këtyre dispozitave ligjore: 1. Nenin 1 të LPP-së 2. Nenin 6 të LPP-së

3. Nenin 7 të LPP-së
4. Nenin 59 të LP-së
5. Neni 60 të LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti kontraktues na ka shpallur si tenderues i pasuksesshëm dhe e ka rekomanduar për kontratë operatorin ekonomik të papërgjegjshëm.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës kemi bërë kërkesën për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues me dt:29.06.2017.
Autoriteti kontraktues me dt:03.07.2017 na ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim pa dhënë asnjë arsye dhe pa e shqyrtuar fare kërkesën tonë.

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë_____ është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar kërkesën e autoritetit kontraktues në lidhje me specifikimet teknike, ku në dosje të tenderit është kërkuar që saktësia e aparatit të jetë 1 dhe koha e matjes 0.3-0.6 sekonda kurse stacioni total i ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar këtë kërkesë pasi që ka ofertuar Geo Fennel FTS 102.

Seria e përshkruar nga operatori i rekomanduar për kontratë (FTS 102) sipas broshurës –katalogut, nëse shikohet në linkun http:WWW.geofennel.de\fileadmin\pdf\produktkatalog\2016\geoF katalog 2014 EN RZ1 WEB.pdf nuk e ka saktësinë (angle accuracy) 1. Pra nëse shikohet në këtë adresë (e që OSHP duhet ta verifikoj këtë fakt) vërehet që seria e prezantuar në dosje të tenderit nga OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka saktësinë 1 por kjo seri përmban serinë 2. Me këtë rezulton që operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka mundësi që ka ndërhy në katalog për tu shpallur fitues edhe pse në internet vërehet qartë se seria e prezantuar nuk e ka saktësinë 1. Me këtë veprim operatori ekonomik ka ofruar dëshmi të rrejshme edhe pse e ka nënshkruar deklaratën nën betim.

Autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar nenin 59 pargrafi 3 të LPP pasi që aty ceket që "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kurse AK e ka rekomanduar për kontratë OE që nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Me këtë veprim autoriteti kontraktues e ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës duke e shkelur nenin 1 të LPP ku shkruan që qëllimi i këtij ligji është të